

VENDIM
Nr. 327, datë 16.5.2012

**PËR KALIMIN E OBJEKTIT “ISH-POSTA KUFITARE, TAMARË”, NGA MINISTRIA E
BRENDSHME, NË PRONËSI TË KOMUNËS KELMEND, TË QARKUT TË SHKODRËS, SI
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, si dhe të neneve 3 shkronja “a”, 5 e 6 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e objektit “Ish-posta kufitare, Tamarë” nga Ministria e Brendshme, në pronësi të komunës Kelmend, të qarkut të Shkodrës, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kjo pronë të hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryetari i komunës Kelmend dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha